



RIHAPJE E THIRRJES PËR OFERTIM

REOPEN OF THE CALL FOR OFFER

Titulli i projektit / Project Title:	European youth in education and in transition to labour market; Edu-Lab
Titulli i aktivitetit / Activity Title:	Blerje e paisjeve per qellim te implementimit te projektit
Numri i referencës së projektit / Project Reference Number	Horizon Europe (HE) # 101177428)
Agjencia donatore / Sponsoring Agency:	Research Execution Agency (REA)
Periudha e implementimit të projektit/ Project Implementation Period:	1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027

1. Informata rreth Kolegjit AAB

Kolegji AAB është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Kosovë i cili është themeluar menjëherë pas luftës në Kosovë, pas krijimit të rrethanave të reja ekonomike-sociale e kulturore, kur u krijuan kushte dhe rrethana për jetë normale të qytetarëve të Kosovës. Në fillimet e tij institucioni ofroi programe studimore nga fusha e Artit dhe Komunikimit Masiv duke u zgjeruar vazhdimisht me programe studimore në fushat e tjera dhe duke u shndërruar kështu në institucion model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Sot, Kolegji AAB ofron programe studimi të nivelin baçelor dhe master në 14 fakultete të ndryshme. Njëkohësisht, Kolegji AAB është implementues i shumë projekteve ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë.

2. Informata të përgjithshme rreth projektit

Kjo thirrje është e hapur në kuadër të projektit “**EDULAB: Të rinjtë e Evropës në arsim dhe në kalim në tregun e punës**” (**European youth in education and in transition to the labour market**). Projekti ka për qëllim të analizojë shtigjet e tranzicionit në mes të niveleve të ndryshme të arsimit (të përgjithshëm dhe profesional) dhe nga arsimi në tregun e punës. Projekti do të analizojë dhe dizajnojë mekanizma për matjen e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemeve të arsimit me qëllim të identifikimit të rrugëve më fleksibile për kalim të të rinjve në tregun e punës.

Projekti parasheh aktivitetet në vijim:

- Modelimi i shtigjeve dhe tranzicioneve në arsimin e përgjithshëm / në arsimin profesional dhe në tregun e punës;
- Vlerësimi i efikasitetit të politikave dhe investimeve në AP dhe AAP;
- Analiza e të dhënave sasiore në arsimin evropian dhe anketa ndërkombëtare e ekspertëve;
- Dëgjimi i zërave të të rinjve: Raste studimore cilësore;
- Sinteza e kërkimit, integrimi dhe rekomandimet për politikën dhe praktikën; dhe
- Shpërndarja, shfrytëzimi dhe aktivitetet e komunikimit me publikun.

Projekti financohet nga programi Horizon Europe i Bashkimit Evropian.



3. Arsyetim për rihapjen e thirrjes

Ofertat e pranuar nga thirrja paraprake ishin jashtë mundësive buxhetore të projektit dhe koha e liferimit të paisjeve tejkalonte kohën e paraparë për posedimin e paisjeve conform nevojave të projektit. Për këtë arsye, është kryer një rishikim i hollësishëm i specifikave teknike dhe kërkesave për pajisjet e nevojshme. Ky rishikim ka për qëllim të sigurojë që blerjet të përputhen me kapacitetet financiare të projektit, duke ruajtur cilësinë dhe funksionalitetin e pajisjeve.

Gjithashtu, është vlerësuar se disa nga specifikat e mëparshme mund të modifikohen për të siguruar që vlera e paisjeve është brenda buxhetit të paraparë në projekt. Me këtë rihapje, synohet të tërhiqen më shumë oferta konkurruese dhe më të përshtatshme për nevojat aktuale të implementimit të projektit, duke siguruar një proces transparent dhe efikas të prokurimit.

4. Objekti i ofertës

Të gjitha bizneset e regjistruara në Kosovë që të dorëzojnë ofertat e tyre për blerjen e pajisjeve të listuara në vijim:

Nr.	Emërtimi i pajisjeve/	Specifikat teknike të pajisjeve	Sasia
1	Laptop	CPU: Intel Core i7-1355U up to 5.0GHz (12MB Cache) SSD: 512 GB RAM: 16 GB	4
2	Tablet	Android 13 8.7" TFT 1340 x 800 pixels Octa-core (2x2.2 GHz & 6x2.0 GHz) 8 MP, Front: 2 MP 128 GB, 8 GB RAM MicroSD, up to 1 TB Li-Po 5100 mAh Bluetooth, USB type-C v2.0 Wi-Fi 802.11 a/b/g/n/ac/ax, dual-band, Wi-Fi Direct	2
3	Printer	Laser Toner / Black	1
4	Smart TV	75" (165 cm) 4K Ultra HD (3840 x 2160) Smart TV (webOS 24 ThinQ AI Updates 5years) Netflix, Airplay2, Apple Tv, Amazon Prime HDR10, HLG, HGiG, FILMMAKER MODE™ α5 Gen7 AI Processor 4K Magic Remote Wi-Fi, 3x HDMI 2.0, 2 x USB, Optical 20W, Voice control DVB-T2/C/S2	1



5. Kushtet dhe kriteret për aplikim

Të gjitha bizneset e interesuara duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Ofertën financiare (bazuar në specifikat, çmimin e ofruar për njësi dhe kohën e liferimit).
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Certifikatën e TVSH-së

Dokumentacioni i kompletuar duhet **të dorëzohet në formë elektronike** në email-in dardan.krekaj@universitetiaab.com dhe projects@universitetiaab.com me subject **"Ofertë për "Edu-Lab" ose fizikisht në Zyrën për Furnizime në kolegjin AAB**. Çdo formë tjetër e dorëzimit të ofertave do të konsiderohet e papranueshme.

Afati për dorëzimin e ofertave është më 21.03.2025, në ora 16.00.

Përzgjedhja e fituesit do të bëhet në bazë të kriterëve si në vazhdim: çmimit ekonomikisht më të favorshëm (40 pikë), përmbushjes së specifikave teknike (40 pikë), dhe kohës së liferimit (20 pikë).

